



**R E P U B L I K A E S H Q I P E R I S E**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR ELBASAN**  
**KESHILII I GJYKATES**

Nr. \_\_\_\_\_ prot,

ELBASAN me 23.04.2020

**RREGULLORE**

**Date 23.04.2020**

**\*\*Mbi organizimin e punes sipas vendimit nr. 143, date 22.04.2020 te KLGJ “Per rifillimin e veprimtarise dhe sherbimeve gjyqesore ne te gjitha Gjykatat e Republikes se Shqiperise” dhe Aktit Normativ Nr.9 Dt.25.03.2020, miratuar nga Kuvendi I Shqiperise dt.16.04.2020, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan ”**

Bazuar Ligjin nr.98 date 06.10.2016 “Per Organizimin e Pushtetit Gjyqesor ne Republiken e Shqiperise”, nenet 27, 28 dhe 38. qe parashikojne perkatesisht funksionimin dhe kompetencat e Keshillit te Gjykatesm, ne mbledhjen e dt.23.04.2020, bazuar ne Ligjin nr,9887 date 10.03.2008 “Per mbrojtjen e te dhenave personale” i ndryshuar, ne nenin 42 te Ligjit 45/2019 “Per mbrojtjen civile”, me qellim hartimin dhe mbikeqyrjen e zbatimit te nje plani masash organizativc dhe administrative, ne kete suate te epidemise se shkaktuar nga virusi CGVID-19M. Keshilli;

**KOSTATON**

Referuar Vendimit te Kl.GJ nr. 143, date 22.04.2020 “Per rifillimin e veprimtarise dhe sherbimeve gjyqesore ne te gjitha Gjykatat e Republikes se Shqiperise,per Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Elbasan”;

**VENDOSI**

**Te nxjerre nje rregullore ne perputhje me vendimin e mesiperm.**

**Neni 1**

**Objekti i rregullores**

Objekti i kesaj rregulloreje eshte percaktimi nga Keshilli i rregullave dhe praktikave te duhura per kufizimin c perhapjes se COVID-19, gjate vijimit te veprimtarise se Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Elbasan.

**Neni 2**

## **Qellimi i rregullores**

Qellimi I kesaj rregulloreje eshte te siguroje:

- 1.Reduktimin e transmetimit te infeksionit midis punonjesve te Gjykates.
- 2.Sigurimin e nje ambienti te shendetshem ne pune.
- 3.Vijimesine normale te aktivitetit te veprimtarise se Gjykates, ne raport me marrdheniet midis vete punonjesve dhe te paleve te mundshme ne process.

## **Neni 3**

### **Perkufizime**

Per qellime te kesaj rregulloreje, termat e meposhteme kane keto kuptime;

1. Keshilli- eshte Keshilli I Gjykates;
- 2.Punonjesi-eshte çdo anetar I Keshillit dhe Gjykates duke perfshire dhe punonjesit gjyqesore dhe administrata;
- 3.Struktura pergjegjese-eshte Kancelari I Gjykates, Zyra e Finances dhe sherbimet administrative te Gjykates;
- 4.NJVKSH-eshte Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor ne Qarkun e Elbasanit.

## **Neni 4**

### **Masat e pergjithshme te higjienes.**

1 Ne ambientet e Gjykates duhet te sigurohet ne menyre te vazhdueshme perdorimi i produkteve

te higjienes, ku perfshihen sapun i duarve, dezinfektantct me baze alkooli qc kane tc pakten 60% alkool, leter tc pastrimit te duarve ose peshqir me nje perdorim, letra dhe dezinfektante per pastrimin e sipferfaqeve dhe sigurimi i koshave te mbyllur per eliminimin e mbetjeve. Per dezinfektim mund tc perdoren dezinfektuesit shtepiake me te zakonshem.

Punonjesve te Gjykates duhet ti sigurohet ne menyre te vazhdueshme pajisja me mjetet mbrojtese personale si maska dhe doreza (maskat mund ti‘ jene dhe prcj cope dhe tc nderrohen çdo dite). Perdorimi i maskave dhe

dorezave shcrben si barriere fizike per minimizimin/kufizimin e transmetimit te infeksionit COVID-19.

Ne vendin e punes duhet te praktikohet pastrimi i vazhdueshem i siperfaqeve dhe elementeve te tjere te vendit te punes si p.sh.: sallat e gjykimeve, zyrat e punes, tastierat, telefonat, parmaket dhe dorezat.

Produktet dezinfektante qe perdoren per pastrim, te kene perqindjen e alkoolit sipas pikes 1 te ketij neni, metoden e aplikimit dhe kohen e kontaktit te sakte. Ne cdo rast perdorimi i tyre behet duke perdorur mjetet e mbrojtjes personale.

Ne rast se siperfaqet ne vendin e punes jane te ndotura, duhet te pastrohen duke perdorur nje pastrues ose sapun dhe uje, para dezinfektimit.

Disinfektimi i ambienteve te Gjykates te behet cdo fund jave duke bashkepunuar me strukturat perkatese te Bashkise se Qytetit Elbasan

## **Neni 5**

### **Detyrimet e strukture pergjegjese**

- 1, Struktura pergjegjese duhet te vendose postera qe inkurajojne higjienen e duarve per te ndihmuar ne ndalimin e perhapjes ne hyrje te vendit te punes dhe ne zonat e tjera te vendit te punes ku jane te dukshme.
- 2, Struktura pergjegjese duhet te parashikojne nje plan masash per te siguruar distancimin social dhe nese kapaciteti i punonjesve kalon normen e lejuar per siperfaqe ne m<sup>2</sup> duke respektuar distancimin fizik 2m. Ky detyrim duhet respektuar dhe ne rastet e paleve ne gjykim ku nuk do te lejohet hyrja e publikut.
- 3, Ne varesi te masave per distancimin social te parashikuar ne piken 2 te ketij neni, struktura pergjegjese duhet te hartoje nje politike te brendeshme per punonjesit e Gjykates per menyren e kryerjes se punes, konkretisht:
- 4, Zbatimin e vendeve te punes fleksibcl (p.sh. pune ne distance);
- 5, Zbatimin e oreve fleksibel te punes (p.sh. nderrimin e orarit te punes/diteve te punes apo orareve te gjykimeve dhe sherbimeve per administraten, per cdo gjyqtar, ne dite te caktuara dhe orare te caktuara me qellim shmangien e mbi popullimit ne ditet dhe orarin e percaktuar ne ligj;
- 6, Rritjen e hapesires fizike midis punonjesve ne vendin e punes, ne raport dhe me palet e domosdoshme ne gjykim;
- 7, Rritjen e hapesires fizike midis punonjesve te Gjykates dhe qytetareve (p.sh. permes ndarjeve);

- 8, Mundesimin e komunikimeve ne distance (p.sh. telefon, video ose web).
- 9, Struktura pergjegjese duhet te vendose elementet e distancimit fizik me shenja vizuale te dukshme ne sipërfaqen e dyshemese, si dhe rregullorja apo ky vendim mbi masat e kufizimit per perhapjen e COVID-19 duhet te jete e publikuar ne menyre sa me te dukshme.
- 10, Ne ambientet e Gjykates duhet te kete nje mjedis te caktuar per te izoluar nje punonjes apo person, i cili mund te shfaqe shenja klinike te semundjes dhe me pas lajmerohet 127-ta dhe NJVKSH-ja perkatese.
- 11, Struktura pergjegjese per aq sa eshte e mundur duhet te vendose apo vezhgoje me rigorozitet kamerat per te konstatuar nese masat e percaktuara te higjienes dhe kujdesit zbatohen me perpikeri.
- 12, Struktura pergjegjese per aq sa eshte e mundur duhet te permiresoje dhe kontrolloje zbatimin e masave me qellim rritjen e niveleve dezinfektuese ne hyrje te institucionit.

## **Neni 6**

### **Detyrimet e punonjesit**

Punonjesi nuk duhet te perdore telefonat, tavolinat, zyrat ose mjetet dhe paisjet e punonjesve te tjere, kur eshte e mundur, Nese eshte e nevojshme, ato duhet te pastrohen ose dezinfektohen para dhe pas perdorimit.

Punonjesi duhet te perdore mjetet e mbrojtjes personale si maska dhe doreza.

Punonjesi duhet te laje duart ose te perdore dezinfektantet ne rast se jane te ndotura apo pas

hcqjes se maskes dhe dorezave,

Punonjesi nuk duhet te perdorc shtrengimin e duarve por metoda te tjera jokontaktuese te pershendetjes.

Punonjesi duhet te ruaje distancimin social/fizik gjate ushtrimit te aktivitetit te tij prej se paku

2(dy)m.

Punonjesi duhet te respektojte praktikate e etikes respiratorc. kollitjes e tcshtitjes nepermjet venies se gropezes se berrylit perpara gojes dhe hundes.

Punonjesi eshte i detyruar te deklarroje prane struktures pergjegjese nese ka pasur kontakt me persona te cilet

rezultojne te jene te infektuar me Covid-19. Ne rast se punonjesi ka patur apo ka kontakt te ngushte me nje person me Covid-19 duhet te qendroje ne vetekarantinim dhe te njoftoje menjehere strukturen pergjegjese e cila me pas njofton NJVKSH-ne perkatese.

#### **Neni 7**

#### **Dispozitat e fundit**

Ngarkohet per zbatimin e kesaj rregulloreje struktura pergjegjese e Gjykates,dhe Zyra e Finances e Gjykates.

Kv vendim hyn ne fuqi menjehere.

**KRYETARI I KESHILLIT**

**ZIHNI SHAHU**

**ANETAR**

**PAJTIME FETAHU**

**ANETAR**

**LEDIO SULKUQI**